



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 26 gusht 2019
Nr. Ref.:RK 1418/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastet nr. KI19/19 dhe KI20/19

Parashtrues

Muhamet Thaqi dhe Egzon Keka

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 259/2018, të 5 nëntorit 2018 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 748/2018, të 13 gushtit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI19/19 është parashtruar nga Muhamet Thaqi, nga komuna e Kamenicës, i përfaqësuar nga Florent Latifaj, avokat (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i parë i kërkesës).

2. Kërkesa KI20/19 është parashtruar nga Egzon Keka, nga komuna e Kamenicës i përfaqësuar nga Driton Musliu, avokat (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i dytë i kërkesës).
3. Kur Gjykata i referohet bashkërisht parashtruesit të parë dhe të dytë të kërkesës, do t'iu referohet si parashtruesit e kërkesës.

Vendimi i kontestuar

4. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Pml. nr. 259/2018] të 5 nëntorit 2018 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PA1. nr. 748/2018] e 13 gushtit 2018 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [P. nr. 62/2014] e 7 qershorit 2018 të degës së Kamenicës të Gjykatës Themelore në Gjiilan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

5. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Pml. nr. 259/2018] të 5 nëntorit 2019 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [PA1. nr. 748/2018] e 13 gushtit 2018 të Gjykatës së Apelit, përmes të cilit pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
6. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendosë masën e përkohshme, përmes të cilës do të pezullohet fillimi i ekzekutimit të dënimit me burg, derisa të merret një vendim nga Gjykata.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 1 shkurt 2019, parashtruesi i parë i kërkesës e dorëzoi kërkesën KI19/19 në Gjykatë. Në të njëjtën ditë, parashtruesi i dytë i kërkesës e dorëzoi kërkesën KI20/19 në Gjykatë.
9. Më 6 shkurt 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi për rastin KI19/19 gjyqtaren Gresa Caka-Nimani, Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci.

10. Më 12 shkurt 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e parë të kërkesës për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ai sqarim nëse ka parashtruar ankesë kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në po të njëjtën ditë, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës KI19/19 në Gjykatën Supreme.
11. Më 14 shkurt 2019, në pajtim me paragrafin 1 të rregullit 40 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI20/19 me kërkesën KI19/19. Përbërja e Kolegjit shqyrtues mbeti e njëjtë.
12. Më 19 shkurt 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e dytë të kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës KI20/19, si dhe bashkimin e kërkesave KI20/19 me KI19/19. Gjykata, kërkoi nga parashtruesi i dytë i kërkesës sqarimin nëse ka parashtruar ankesë kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë.
13. Më 19 dhe 28 shkurt 2019, respektivisht, parashtruesit e kërkesës e njoftuan Gjykatën se nuk kanë parashtruar ankesë kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë.
14. Më 29 korrik 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 7 qershor 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P. nr. 62/2014] e shpalli parashtruesin e parë të kërkesës fajtor për ndihmë në veprën penale të përcaktuar me nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 327 (Vjedhje e rëndë) lidhur me nenin 31 (Bashkëkryerja) dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 33 (Ndihma) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK), ndërsa parashtruesin e dytë të kërkesës për bashkëkryerjen e veprës penale të përcaktuar nga nënparagrafi 1.1 i paragrafit 1 të nenit 327 (Vjedhje e rëndë) lidhur me nenin 31 (Bashkëkryerja) të KPRK-së.
16. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit përkatës e dënoi parashtruesin e parë të kërkesës me dënim (i) me gjobë prej 300 euro, e cila do të arkëtohej në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, ndërsa në të kundërtën do të zëvendësohej me dënim me burgim; dhe (ii) me burgim me kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, ekzekutimi i të cilit nuk do të bëhej nëse ai brenda afatit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, nuk kryen vepër tjetër penale. Ndërsa parashtruesin e dytë të kërkesës me dënim (i) me gjobë prej 500 euro, e cila do të arkëtohej në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, në të kundërtën do të zëvendësohej me dënim me burgim; dhe (ii) me burgim me kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, ekzekutimi i të cilit nuk do të bëhej nëse ai brenda afatit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, nuk kryen vepër tjetër penale.
17. Gjykata Themelore arsyetoi se me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së sanksioneve penale, kishte vendosur në bazë të nenit 74 (Rregullat e përgjithshme për zbutjen dhe ashpërsimin e dënimeve) të KPRK-së. Si rrjedhojë, për parashtruesit e kërkesës kishte marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe

rënduese, duke përfshirë faktin që të njëjtit kanë qenë të dënuar në bazë të tri aktgjyqimeve të tjera të nxjerra në vitin 2009, 2015 dhe 2017, respektivisht.

18. Në një datë të paspecifikuar, Prokuroria Themelore në Gjilan, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që të ndryshohet Aktgjykimi i shkallës së parë dhe parashtruesve të kërkesës t'u shqiptohet një dënim më i lartë dhe i cili do të jetë proporcional me peshën e veprave penale, dhe posaçërisht faktin që parashtruesit e kërkesës kanë qenë të dënuar më parë përmes tri aktgjyqimeve. Qëndrimet e Prokurorisë Themelore të Gjilanit u mbështetën edhe përmes shkresës [PPA/II. nr. 754/2018] të 20 korrikut 2018 të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë. Parashtruesit e kërkesës nuk kishin paraqitur ankesë.
19. Më 13 gusht 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1.nr.748/2018] e ndryshoi Aktgjykimin [P. nr. 62/2014] e 7 qershorit 2018 të Gjykatës Themelore, sa i përket lartësisë së dënimit. Gjykata e Apelit, parashtruesve të kërkesës u shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh.
20. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë të përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë duke pretenduar shkelje të ligjit penal dhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në anën tjetër, Prokurori i Shtetit propozoi hedhjen si të palejuar të kësaj kërkesë të parashtruesve të kërkesës duke arsyetuar, ndër të tjera, se një kërkesë e tillë nuk mund të pranohej për shqyrtim sepse mbrojtësi përkatës nuk kishte paraqitur autorizimin për ushtrimin e këtij mjeti juridik.
21. Më 5 nëntor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Pml. nr. 259/2018], hodhi si të papranueshme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesve të kërkesës. Gjykata Supreme refuzoi kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë në dy pika kryesore. Fillimisht, Gjykata Supreme duke u bazuar në paragrafin 1 të nenit 433 (Personat e autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë) të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPRK), në të cilin përcaktohen palët që mund ta parashtrojnë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë theksoi se kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e ka parashtruar avokati F. A., i cili nuk ka provë se ka autorizim për ushtrimin e mjetit juridik, dhe rrjedhimisht kërkesa përkatëse nuk është paraqitur nga personi i autorizuar. Së dyti, Gjykata Supreme duke u bazuar në nenin 55 (Kufizimet në përfaqësim nga mbrojtësi) të KPPRK-së arsyetoi se mbrojtësi nuk mund t'i mbrojë dy apo më shumë të pandehur në të njëjtën çështje dhe në rastin konkret rezultoi që ka ushtruar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë për të dy parashtruesit e kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktvendimi [Pml. nr. 259/2018] i 5 nëntorit 2018 i Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimi [PA1. nr. 748/2018] i 13 gushtit 2018 i Gjykatës së Apelit, respektivisht, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

23. Përkitazi me të parin, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme, parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse, sipas pretendimit ky vendim “[...] është i gabueshëm ngase kanë qenë vetë [parashtruesit] të cilët e kanë nënshkruar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë [...]”, ndërsa parashtrësja është hartuar dhe është vulosur nga hartuesi, përkatësisht avokati, mirëpo nuk është dorëzuar nga ana e tij, ngase të njëjtën e kanë dorëzuar vet parashtruesit e kërkesës.
24. Ndërsa, përkitazi me të dytin, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe specifikisht të drejtës për një seancë dëgjimore. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se Gjykata e Apelit kishte nxjerrë Aktgjykimin përkatës duke e ngritur lartësinë e dënimit të tyre të përcaktuar nga Gjykata Themelore, përkatësisht nga burgimi me kusht në burgim efektiv me kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, pa i ftuar ata në seancë dëgjimore. Në mbështetje të pretendimeve të tyre për shkelje të së drejtës në një seancë dëgjimore, parashtruesit e kërkesës gjithashtu i referohen Aktgjykimit të Gjykatës, në rastin KI104/16, të 4 gushtit 2017 (shih rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues Miodrag Pavić, Aktgjykim i 29 majit 2017).
25. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që kërkesat e tyre të shpallen të pranueshme; të miratohet kërkesa e tyre për masë të përkohshme dhe të anulohet Aktvendimi [Pml. nr. 259/2018] i 5 nëntorit 2018 i Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimi [PA1. nr. 748/2018] i 13 gushtit 2018 i Gjykatës së Apelit.

Dispozitat përkatëse ligjore

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE

Neni 55

Kufizimet në përfaqësim nga mbrojtësi

1. Në një procedurë penale, mbrojtësi nuk mund të mbrojë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje. Një mbrojtës nuk mund të përfaqësojnë personin juridik dhe personin fizik në të njëjtin rast, përveç nëse personi fizik është i vetmi person që ka në pronësi, menaxhon dhe është i punësuar nga personi juridik.

(...)

Neni 433

Personat e autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë

1. Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesë Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 424, paragrafi 1. fjalitë e fundit e këtij Kodi.

(...)

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata vëren që parashtruesit e kërkesës para Gjykatës kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së (i) Aktvendimit [Pml. nr.2 59/2018] të 5 nëntorit 2018 të Gjykatës Supreme; dhe (ii) Aktgjykimit [PA1. nr. 748/2018] të 13 gushtit 2018 të Gjykatës së Apelit. Në vijim, Gjykata do të shqyrtojë vlerësimin e pranueshmërisë të secilit prej tyre.

Në lidhje me Aktvendimin [Pml. nr. 259/2018] e 5 nëntorit 2018 të Gjykatës Supreme

27. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ”.

30. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuar, dhe të cilët kontestojnë një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin [Pml. nr. 259/2018] e 5 nëntorit 2018 të Gjykatës Supreme, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ata pretendojnë se u janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
31. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:
- “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
32. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës ishin shpallur fajtor përmes Aktgjykimit [P. nr. 62/2014] të 7 qershorit 2018 të Gjykatës Themelore, për kryerjen e veprës penale të vjedhjes së rëndë, sipas specifikave të përshkruara në Aktgjykimin përkatës, dhe për kryerjen e kësaj vepre penale, ishin dënuar me gjobë dhe dënim me burgim me kusht. Pranë Gjykatës së Apelit, Prokurori i Shtetit kishte parashtruar ankesë duke kërkuar që të rritet lartësia e dënimit, posaçërisht duke marrë parasysh faktin që të njëjtit ishin dënuar më parë edhe përmes tri aktgjykimeve të tjera. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1. nr. 748/2018] të 13 gushtit 2018 e ndryshoi Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket dënimit, duke iu shqiptuar parashtruesve të kërkesës dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh. Parashtruesit e kërkesës nuk ishin thirrur në seancë dëgjimore pranë Gjykatës së Apelit. Pas këtij vendimi, ata kishin parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme, kërkesë kjo e cila ishte shpallur e papranueshme përmes Aktvendimit të cilin parashtruesit e kërkesës e kontestojnë para kësaj Gjykate, duke pretenduar shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
33. Më specifikisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme nuk kishte interpretuar drejt KPPRK-në kur kishte refuzuar kërkesën e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë sepse e njëjta edhe pse kishte qenë e përgatitur dhe vulosur nga avokati, ajo gjithashtu kishte qenë e nënshkruar prej tyre, dhe si e tillë do të duhej të pranohej nga Gjykata Supreme.

34. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që Gjykata Supreme kishte konstatuar se kërkesa e parashtruesve të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë është e papranueshme sepse (i) bazuar në shkresat e lëndës, avokati F. A. nuk ka pasur autorizim për ushtrimin e këtij mjete juridik; dhe (ii) i njëjti kishte përfaqësuar më shumë se një të pandehur në kundërshtim me Kodin e procedurës. Në arritjen e këtij konstatimi Gjykata Supreme ishte bazuar në paragrafin 1 të nenit 433 të KPPRK-së dhe në nenin 55 të KPPRK-së.
35. I pari, përkatësisht neni 433 i Kodit të Procedurës, përcakton personat e autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe sipas paragrafit 1 të tij, *“kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesë Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij”*. Ndërsa i dyti, përkatësisht neni 55 i Kodit të Procedurës, përcakton kufizimet në përfaqësim nga mbrojtësi. Sipas paragrafit 1 të tij, *“në një procedurë penale, mbrojtësi nuk mund të mbrojë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje”*.
36. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit të saj, ndër të tjera, kishte theksuar:
- “Nga shkresat e lëndës rezulton se kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka paraqitur Avokati F. A. nga Gjilani, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë provë se mbrojtësi ka pasur autorizim për ushtrimin e këtij mjete juridik”*.
37. Për më tepër, Gjykata Supreme gjithashtu specifikisht adresoi çështjet që ndërlidhen me (i) paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë nga personi i paautorizuar; dhe (ii) kufizimet e një mbrojtësi për të mbrojtur dy ose më tepër të pandehur në një çështje penale.
38. Përkitazi me çështjen e parë, Gjykata Supreme, sqaroi se:
- “Dispozita e nenit 433 par 1 të KPPK-së, përcakton se kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqet Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtës i tij. Pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë nga neni 424, par 1 të KPPK-së. Mirëpo, siç u elaborua më lart kërkesa në fjalë është paraqitur nga personi i paautorizuar, pra në kundërshtim me dispozitën e lartcekur[...].”*
39. Ndërsa, përkitazi me çështjen e dytë, Gjykata Supreme, sqaroi se:
- “Në pajtim me dispozitën e nenit 55 të KPPK-së, në një procedurë penale, mbrojtësi nuk mund të mbrojë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje, ndërsa në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se mbrojtësi ka ushtruar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të dy të dënuarve Egzon Keka dhe Muhamet Thaqi, që është në kundërshtim me dispozitën e lartcekur ligjore”*.
40. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte arsyetuar shpalljen e papranueshme të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë bazuar në dispozitat përkatëse të KPPRK-së.

41. Për më tepër, dhe në këtë kontekst të pretendimeve për interpretimin e gabuar të ligjit, Gjykata ka theksuar vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet faktike ose ligjore që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata nuk mund t'i vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë shtyrë gjykatën e rregullt të merr pikërisht vendimin të cilin e kishte marrë, dhe jo një vendim të ndryshëm. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata atëherë do të vepronte si “*gjykatë e shkallës së tretë ose të katërt*”, gjë që do të paraqiste mosrespektimin e kufijve të cilët janë të imponuar me juridiksionin e saj. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Perlala kundër Greqisë*, Aktgjykim i 22 shkurtit 2007, paragrafi 25; si dhe, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI119/17 parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 prillit 2019, paragrafi 87).
42. Gjykata gjithashtu thekson se bazuar dhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk është detyrë e saj të vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit nga gjykatat e rregullta, përveç në rastet e arbitraritetit të dukshëm. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Adamsons kundër Letonisë*, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118 si dhe rastet e Gjykatës KI42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 dhjetorit 2017, paragrafi 38; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 60). Rrjedhimisht, Gjykata duhet të sigurohet dhe të ndërmerr masa kur vëren se një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*”. (Shih, për këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83; *Beyeler kundër Italisë*, Aktgjykim i 5 janarit 2005, paragrafi 108; dhe shih gjithashtu, rastet e Gjykatës KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 40 e 41; si dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, cituar më lart, paragrafi 59).
43. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Aktgjykim i 30 qershorit 2009). Gjykata thekson se procedura pranë Gjykatës Supreme ishte e bazuar në dispozitat relevante të KPPRK-së dhe hedhja poshtë e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë ishte e bazuar në interpretimin e dispozitave të KPPRK-së.
44. Gjykata, në fund gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtruesve të kërkesës me rezultatin e procedurave nga gjykatat e rregullta nuk mundet vetvetiu të paraqesë pretendim të argumentueshëm për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
45. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës përkitazi me Aktvendimin [Pml. nr. 259/2018] e 5 nëntorit 2018 të Gjykatës Supreme nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, sepse ata nuk kanë dëshmuar dhe nuk kanë

mëshpëtur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

Në lidhje me Aktgjykimin [PA1. nr. 748/2018] e 13 gushtit 2018 të Gjykatës së Apelit

46. Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesave së parashtruesve të kërkesës, Gjykata përtej paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe neneve 47, 48 dhe 49 të Ligjit, e të cituara më lart, Gjykata gjithashtu i referohet pikës (c) të paragrafit 1 të rregullit 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] të Rregullores së punës, dhe i cili përcakton:

Rregulli 39
[Kriteret e Pranueshmërisë]

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi; ose

[...]"

47. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se neni 49 i Ligjit në lidhje me pikën (c) të paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton se kërkesat e parashtruesve, përkatësisht pretendimet për shkelje kushtetuese kundër një akti të autoritetit publik, duhet të parashtrohen në Gjykatë brenda afatit prej 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit gjyqësor.
48. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin [PA1. nr. 748/2018] e 13 gushtit 2018 të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse dënimi i tyre i përcaktuar nga Gjykata Themelore ishte rritur, përkatësisht shndërruar në burgim efektiv prej burgimit me kusht, përkundër faktit që (i) ata nuk kishin parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore; dhe (ii) nuk ishin ftuar në seancë gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit.
49. Gjykata vëren që parashtruesit e kërkesës nuk kanë dorëzuar në Gjykatë dëshminë së kur e kanë pranuar këtë Aktgjykim. Megjithatë, Gjykata bazuar në shkresat e lëndës vëren se parashtruesit e kërkesës, kërkesën e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme e kishin parashtruar më 13 shtator 2018. Edhe po të llogaritej kjo e fundit si data kur parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, kërkesa e parashtruesve të kërkesës në Gjykatë kundër këtij Aktgjykimi është parashtruar më 1 shkurt 2019, dhe rrjedhimisht jashtë afatit 4 (katër) mujor të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës.
50. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë

siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe që vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 25 gushtit 2005; *Sabri Güneş kundër Turqisë*, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 39; dhe rastet e Gjykatës KI140/13, me parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24; e KI120/17, me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 39).

51. Rrjedhimisht, dhe si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës kundër Aktgjykimit [PA1. nr. 748/2018] të 13 gushtit 2018 të Gjykatës së Apelit, nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht, pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre themelore përkitazi me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit.
52. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesat e parashtruesve të kërkesës nuk i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Ajo thekson se pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me (i) Aktvendimin [Pml. nr. 259/2018] e 5 nëntorit 2018 të Gjykatës Supreme, janë të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në përputhje me paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës, sepse parashtruesit e kërkesës nuk kanë mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre; ndërsa pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me (ii) Aktgjykimin [PA1. nr. 748/2018] e 13 gushtit 2018 të Gjykatës së Apelit janë të papranueshme në përputhje me nenin 49 të Ligjit dhe pikën (c) të paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës, sepse janë të paafatshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

53. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar vendosjen e masës së përkohshme duke kërkuar që të pezullohet fillimi i ekzekutimit të dënimit me burg derisa të merret një vendim nga Gjykata.
54. Gjykata tanimë ka konkluduar se kërkesat e parashtruesve të kërkesës duhet të deklarohen të papranueshme.
55. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës, kërkesat e parashtruesve të kërkesës për masë të përkohshme duhet të refuzohen, sepse të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi, pasi janë shpallur të papranueshme. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, KI159/18, parashtrues *Azem Duraku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 prillit 2019, paragrafi 91; dhe KI13/19, parashtrues *Fevzi Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2019, paragrafi 75).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 27 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (1) (c), 39 (2), dhe 57 (1) të Rregullores së punës, më 29 korrik 2019, njëzëri

VENDOS

- I. T'I DEKLAROJË kërkesat të papranueshme;
- II. T'I REFUZOJË kërkesat për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi